



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:153092
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05595245

Ac.nr.5837/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Fatmir Baloku, kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Liridon Maloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.K nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Th, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, për kompensimin në emër të pagës së 13-të dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit dhe ankesës së të paditurës, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren -Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1413/21, të datës 23.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.04.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN SI TË PA BAZUARA ankesa e të autorizuarit të paditësit Sh.K nga Prizreni dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren -Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1413/21, të datës 23.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1413/21, të datës 23.06.2023, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit Sh.K, nga Prizreni ashtu që DETYROHET e paditura Policia e Kosovës, që paditësit, në emër të kompensimit të tri pagave mujore (pagës së trembëdhjetë), t’ia paguaj shumën prej 531,90 € x 3 (pesëqind e tridhjetë e një euro e nëntëdhjetë cent), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumë të përgjithshme prej 1.595,70 € (një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë cent) e me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (dt 13.07.2021) e deri në pagimin definitiv, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. II.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të “Obligohet e paditura Policia e Kosovës, që në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 707 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1.767,50 (njëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare”, si e pa bazuar. III.DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 144.00, (njëqind e katërdhjetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, duke e atakuar të njëjtin në pikën II të dispozitivit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë në pikën II të dispozitivit, ashtu që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin edhe të shujtave ditore apo aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit ta prish dhe lënda ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur edhe pala e paditur, duke e atakuar të njëjtin në pikën I dhe III të dispozitivit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur palët ndërgjyqëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe ankesa e të paditurës janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Sh.K nga Prizreni, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 13.07.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, me detaje si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Kur gjykata, pasi ti arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozite ligjore ka nxjerrë aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, pasi që bazohet në udhëzimin administrativ me numër 02/2018 të Policisë së Kosovës, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: nuk rezulton të jetë kontestuese fakti se paditësi që nga viti 2000 është në marrëdhënie pune te e paditura, mirëpo mbetet kontestuese fakti se paditësit a i takon kompensimi për pagën e trembëdhjetë si dhe kompensimi për shujtat ditore, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet

nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi ka qenë për vitin 2018, 2019 dhe 2020, ka qenë plotësisht i kënaqshëm dhe ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore, (duke vendosur me *decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi*). Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës që në emër të kompensimit të ushqimit të në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 707 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1.767,50 € vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”. Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe atë për periudhën 2018, 2019 deri më 2020, pasi që paditësi nuk ka arritur që të provojë se këtu me të paditurën si punëdhënëse ka raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i kanë pretenduar palët ankuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon si dhe lartësia e pagës bazë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit, se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që sipas nenit 29 par.1 të Udhëzimit Administrativ 02/2018, të datës 14.11.2018, parashihet që: “*Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici*”, andaj referuar kësaj dispozite, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e shujtave ditore, pasi që paragrafi 1 i nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe paragrafi 1 i nenit 30 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, nuk kanë karakter detyrues dhe si të tilla nuk e obligojnë të paditurën për pagesë të shujtave ditore të pretenduara nga paditësi. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku në pikën I të këtij mendimi është përcaktuar se: “*Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi I i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë*

14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi I i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021''.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29 par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nen shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësit është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe detyruar të paditurën që paditësit Sh.K t'ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore në emër të pagës së 13-të, në shumën prej 1,595.70 €, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të performances, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ me numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Gjykata e Apelit, pretendimin ankimor të të paditurës se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e pagave të 13-ta është parashkruar, nuk e mori parasysh, pasi që sipas shkresave të lëndës rezultoi se e paditura nuk është thirrur në institutin e parashkrimit gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në shkallë të parë (*përmes përgjigjes në padi*), por vetëm në ankesën e parashtruar në gjykatën e shkallës së dytë. Andaj, bazuar në nenin 180 parag.3 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qellim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, për çka edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur të marrë parasysh këtë pretendim të palës ankuese.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:153092
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05595245

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.5837/23, me datë 19.04.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v